

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“PULAT E NËNËS” SHPK**

Ortakët themelues si më poshtë:

- **Z. Vladimir Hysenaj**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 01.08.1964, lindur në Çyçen dhe banues në Fier, lagjja “Konferenca e Pezës”, pranë 15 katëshit, mbajtës i letërnjoftimit nr. 037016938;
- **Znj. Luljeta Hysenaj**, shtetase shqiptare, e datëlindjes 28.01.1969, lindur në Aranitas dhe banuese në Fier, lagjja “Konferenca e Pezës”, pranë 15 katëshit, mbajtëse e letërnjoftimit nr. 035208748;

bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), sot më datë 15.01.2024, hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

**NENI 1**

**Emri**

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “PULAT E NËNËS”.  
Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 2**

**Forma**

Shoqëria tregtare “PULAT E NËNËS”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 3**

**Zyra Qendrore**

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “PULAT E NËNËS” SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën lagjja “29 nëntori”, rruga “Dervish Hekali”, Godina 23, Hyrja 3, “Njësi” me nr. pasurie 5/150+3-14/2, ZK 8533, Fier, Shqipëri.

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 4**

**Objekti i Veprimtarisë**

Shoqëria ka si objekt aktiviteti rritjen, mbarështimin dhe prodhimin e shpendëve, kafshëve dhe të produkteve dhe nënprodukteve të tyre brenda dhe jashtë vendit. Import- Eksport i produkteve blegtorale dhe bujqësore. Grumbullim, përpunim, paketim dhe depozitim në frigorifer të artikujve bujqësor e blegtoral, të të gjitha llojeve të produkteve të përgatitura ose gjysmë të gatshëm, me origjinë bimore ose shtazore, etj. Depozitimi në frigorifer për llogari të të tretëve i të gjitha llojeve të mallrave, lëndëve të para, pije etj. Thertore për kafshët/shpendët (zogj) për vete dhe për llogari të të tretëve. Shoqëria mund të bashkëpunojë me shoqëri të tjera, vendase apo të huaja, për përmbushjen e objektit të aktivitetit të saj.

**NENI 5**

**Kohëzgjatja**

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

**NENI 6**

**Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit**

Shoqëria tregtare “PULAT E NËNËS” SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

**NENI 7**  
**Përgjegjësia e Ortakëve**

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë "PULAT E NËNËS" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

**NENI 8**  
**Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat**

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "PULAT E NËNËS" SHPK është 100,000 (njëqind mijë) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga të gjithë ortakët.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të shoqërisë dhe zotërojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- Ortaku Vladimir Hysenaj, zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit me vlerë 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej 50 % (pesëdhjetë përqind) në kapitalin e shoqërisë;
- Ortaku Luljeta Hysenaj, zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit me vlerë 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej 50 % (pesëdhjetë përqind) në kapitalin e shoqërisë.

**NENI 9**  
**Organet e Shoqërisë**

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

**NENI 10**  
**Administratori**

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 3 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administrator i Shoqërisë do të jetë ortakë Luljeta Hysenaj.

**NENI 11**  
**Sekreti tregtar**

Ortakët, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë "PULAT E NËNËS" SHPK përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.


**NENI 12**

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës kompetente.

**Ky Akt Themelimi përpilohet në 3 (tre) origjinale në gjuhën shqipe.**

**ORTAKËT THEMELUES**

**VLADIMIR HYSENAJ**



**LULJETA HYSENAJ**

